

BURSA SHQIPTARE ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A

Nr. 400 Prot.

Tiranë, më 10.11.2023

Lënda: Mbi caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (shipping agent) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipërisë – Kosovë.

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Blvd. “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, nr. 1023, Tirane

I nderuar Z. Ahmeti,

Sikurse jeni në dijeni OST SHA, KOSTT SHA dhe ALPEX SHA janë duke bashkëpunuar në lidhje me realizimin e bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike, të ditës në avancë, Shqipëri-Kosovë, në kuadër të përmbushjes të përcaktimeve të marrëveshjes kornizë të datës 21.10.2021 “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”, nënshkruar ndërmjet ERE, ZRRE, OST dhe KOSTT.

Në “Rregullore e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësive të NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 40, datë 06.03.2020, është parashikuar, ndër të tjera, edhe roli i Agjentit të Transferimit (shipping agent) dhe konkretisht në nenin 2, “Përkufizime” thuhet se:

“Agjent transferimi” Është subjekt/subjekte që kanë për detyrë transferimin e pozicioneve neto ndërmjet Palëve Qendrore të ndryshme.

Agjenti i transferimit (Shipping Agent) mund të veprojë si kundërpalë ndërmjet kundërpalëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë elektrike, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim.

Më tej, në rregulloren e miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 40, datë 06.03.2020, në nenin 5 “Detyrat e NEMO në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtës ditë” përcaktohet se:

NEMO do të jetë veçanërisht përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

k. Të kryejë rolin e një agjenti të transferimit, nëse vendoset nga Autoriteti Rregullator ERE.

dhe në neni 6 “Detyrat e OST në lidhje tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe brenda te njëjtës dite” përcaktohet se:

Detyrat që OST do të realizojë:

j. Në rastin kur është rënë dakord, do të veprojë si agjent transferimi për transferimin e pozicioneve neto ne treg.

k. Do të luajë rolin e agjentit të transferues nëse është vendosur nga ERE.

Pra roli i “agjentit të transferimit” në një bashkim tregu vendoset nga ERE.

Në rekomandimin e dhënë nga Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) në mbledhjen e datës 24.04.2019, e cila është marrë në konsideratë nga ERE në hartimin e “Rregullores e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar”, Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë është shprehur se:

Zakonisht agjentë Transferimi janë NEMO, por është gjithashtu e mundur që OST-të ta kryejnë këtë aktivitet në përputhje me Nenin 8 (l) të Rregullores CACM. Për më tepër, në përputhje me nenin 68 (6.) të Rregullores CACM, një agjent Transferimi mund të veprojë si kundër palë ndërmjet palëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim.

Për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë rekomandohet gjithashtu t'i referohen një NEMO (d.m.th. operatori i tregut) për t'u përafuar me dispozitat e Rregullores CACM.

Nisur nga ky rekomandim, nga eksperiencia e ndjekur nga vendet evropiane por edhe nga fakti që ALPEX SHA, vepron si një Kundërpalë Qendrore (CCP) për klerimin dhe shlyerjen e shkëmbimit të energjisë që rezulton nga bashkimi i tregut të ditës në avancë, propozojmë që ERE të shprehet me vendim, që roli i “Agjentit të transferimit”, për bashkimin e tregjeve të energjisë Shqipëri-Kosovë, të kryhet nga ALPEX SHA.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ALPEX SHA, mbetet në dispozicionin tuaj,

Me respekt,

ADMINISTRATORI I ALPEX SHA.

Sokol Dishnica

